


PwC Albania

Tax and Legal Alert

April 2021



PwC Albania - Tax and Legal Alert

April 2021

In this summary you will find a selection of the latest tax and legal amendments in March 2021.

On amendments to the agreement between the governments of Albania and Kosovo for the avoidance of double taxation

Under this protocol, income derived from or through an entity or agreement which is treated as partially or wholly fiscally transparent under the tax laws of each Contracting State shall be deemed to be the income of a resident of a Contracting State, but only to the extent that the income is treated for tax purposes by that State, as income generated from the resident of that State.

Dividends may also be taxed in the Contracting State in which the dividend-paying company is resident and in accordance with the laws of that State. If the recipient company (other than a partnership) directly or indirectly owns at least 25% of the capital of the paying company for a period of 365 days which includes the day of dividend payment, a 5% rate of the gross amount of the dividends applies. A tax rate of 8% of the gross amount of the dividends applies in all other cases.

Royalties arising in a Contracting State and paid to a resident of the other Contracting State may be taxed in that Other State. However, royalties may also be taxed in the Contracting State in which they are created and under the laws of that State, but if the recipient of the royalty is a resident of the other Contracting State, then the tax charged shall not exceed 10%.

Royalty income shall be deemed to arise in a Contracting State when the payer is a resident of that State. However, if the person paying the royalty income, whether resident in the Contracting State or not, has a permanent establishment or a fixed place in a Contracting State, and such income is covered by that permanent establishment or that fixed place, then the royalty income is considered to arise in the State in which the permanent establishment or fixed place is situated.

[Source: Law no. 12/2021 "On the ratification of the Amending Protocol to the Agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the Government of the Republic of Kosovo on the avoidance of double taxation, related to taxes on income and on capital, and on the prevention of tax evasion", ratified by law no. 62/2014]

Amendments to the Instruction on the invoice and the turnover monitoring system

According to these changes:

- If the buyer who has rejected the invoice, makes full or partial payment of the rejected invoice through the banking system, then this invoice is automatically considered accepted and is registered in the buyer's purchase book despite the previous refusal;
- Invoices issued from entities operating in the field of telecommunications, insurance, electricity and water supply, as well invoices continuously supplied based on long-term leasing contracts or other long-term contracts, will be considered automatically fiscalized even if the buyer is in passive status;
- If invoices are not declared by the taxpayer, the data information from the purchase and sale books recorded until the tenth day of the following month, will be declared automatically. These data will be used to complete and account for the VAT declaration return of the respective month, even if the taxpayer has not confirmed them.

[Source: Instruction no. 5, dated 23.2.2021 for some additions and an amendment to the instruction no. 16. dated 3.4.2020 "On the invoice and the turnover monitoring system"]

Prill 2021

Në këtë përmbledhje do të gjeni ndryshimet e fundit tatimore dhe ligjore të cilat janë miratuar.

Për ndryshime në marrëveshjen midis qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës për shmangjen e tatimit të dyfishtë

Sipas këtij protokoll, të ardhurat që rrjedhin nga një subjekt apo marrëveshjeje e konsideruar transparente nga aspekti fiskal, bazuar në ligjet tatimore të Shteteve Kontraktuese përkatëse, konsiderohen të jenë të ardhura të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, në masën që e ardhura trajtohet për qëllime të tatimit nga ai Shtet, si e ardhur e rezidentit të atij Shteti.

Dividendet mund taten edhe në Shtetin Kontraktues, ku shoqëria paguese e dividendëve është rezidente në përputhje me ligjet e këtij Shteti. Nëse kompania përfituese (përveç ortakësisë) zotëron drejtpërdrejt ose indirekt të paktën 25% të kapitalit të kompanisë paguese për një periudhë 365 ditore që përfshin ditën e pagesës së dividendit, aplikohet një normë prej 5% mbi shumën bruto të dividendëve. Një normë prej 8% mbi shumën bruto të dividendëve zbatohet për rastet e tjera.

Të ardhurat nga e drejta e pronësisë që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër kontraktues mund të taten në atë Shtet tjetër. Megjithatë, e ardhura nga e drejta e pronësisë mund të taten edhe në Shtetin kontraktues në të cilin krijohen dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i të drejtave të pronësisë është rezident i Shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 10% të shumës bruto të të drejtave të pronësisë.

Të ardhurat nga e drejta e pronësisë konsiderohen të lindin në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezidenti i atij Shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan të ardhurat nga e drejta e pronësisë, qoftë rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues seli të përhershme ose bazë fikse, dhe këto të ardhura mbulohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë të ardhurat nga e drejta e pronësisë konsiderohen të lindin në Shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

[Burimi: Ligj Nr. 12/2021 "Për ratifikimin e Protokollit Ndryshues të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangjen e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, dhe për parandalimin e evazionit fiskal", ratifikuar me ligjin nr. 62/2014]

Për ndryshime në udhëzimin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit

Sipas këtyre ndryshimeve:

- Nëse blerësi që ka refuzuar faturën, kryen pagesën e plotë apo të pjesshme të faturës së refuzuar nëpërmjet sistemit bankar, atëherë kjo faturë çmohet automatikisht e pranuar dhe regjistrohet në librin e blerjes së blerësit pavarësisht refuzimit paraprak;
- Do të çmohen të fiskalizuar automatikisht dhe pavarësisht statusit të blerësit nëse është aktiv apo pasiv, faturat e fiskalizuar nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e telekomunikacionit, sigurimeve, furnizimit të energjisë elektrike dhe ujit për konsumatorët finalë, si dhe faturat mujore të lidhura me kontrata afatgjata leasing dhe fatura të ngjashme me to, të cilat lëshohen në mënyrë të vazhdueshme dhe mbi bazën e një kontrate afatgjatë të lidhur paraprakisht nga palët;
- Nëse faturat nuk janë deklaruar nga ana e tatimpaguesit, të dhënat nga librat e blerjeve dhe shitjeve të evidentuara deri në ditën e dhjetë të muajit pasardhës, do të deklarohen automatikisht. Këto të dhëna do të përdoren për të plotësuar dhe kontabilizuar deklaratën e TVSH-së së muajit respektiv, pavarësisht nëse tatimpaguesi i ka konfirmuar ose jo.

[Burimi: Udhëzim nr. 5, datë 23.2.2021 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin nr 16. datë 3.4.2020 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"]

Regarding standard billing procedures within the Fiscalization process

The General Directorate of Taxes clarifies that in cases where the invoice date differs from the date of supply of goods or services, then both moments must be clearly evidenced in the fiscalized invoice.

[Source: "Notification of the General Directorate of Taxes regarding the standard billing procedures within the Fiscalization process"]

On the installment payment agreement for unpaid taxes

The Tax Administration notifies that all taxpayers who are temporarily in a difficult financial situation, have the possibility to pay in installments an unpaid tax liability through a written request to the Director of the Regional Tax Directorate where they are registered.

[Source: "Notification of the General Directorate of Taxes regarding the installment payment agreement for unpaid taxes"]

Submission of tax documentation

The General Directorate of Taxes notifies all taxpayers who will no longer be subject to VAT of the obligation they have to deposit the tax documentation (VAT invoices) at the respective Regional Tax Directorates that have been engaged for their distribution.

The deadline for the submission of the unused VAT invoices will be the period 01 March - 31 August 2021.

[Source: "Notification of the General Directorate of Taxes regarding the submission of tax documentation from Taxpayers exempted from VAT"]

National taxes

For the sale of the mineral of the first group (I), "Metal Minerals", royalty tax will be 3/7th of the royalty tax rate in 2019, 0% for the period from the entry into force of this law up to the end of 2023, and 1/3rd of the royalty tax rate in 2024 and onwards.

[Source: "Law no. 151/2020 for an amendment to law no. 9975, dated 28.7.2008, "On national taxes", as amended"]

Custom tariffs

The customs tariff for the code NKM 8903 10, "other water vehicles for leisure and sports, inflated with air or gas", is changed from 15 percent to 2 percent.

[Source: "Law no. 168/2020 for an amendment to law no. 9981, dated 8.9.2008, "On the approval of customs tariff levels", as amended"]

On the Beneficial Owners Register

Through a Normative Act, the Council of Ministers in the Republic of Albania decided to extend the deadline for the Registration of the Beneficiary Owners for all reporting entities until 30.06.2021 (currently 31.03.2021). In addition to the approved amendments, the reporting entities shall be able to file any changes of the Beneficiary Owners data within 90 days (currently 30 days) from the date of the change occurred.

[Source: Normative Act of Council of Ministers no. 12, date 25.3.2021, for some changes and amendments in the law no. 112/2020 "On the Beneficial Owner Register"]

Lidhur me procedurat standarde të faturimit në kuadër të procesit të Fiskalizimit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sqaron se për rastet kur data e faturës nuk është e njëjtë me datën e furnizimit të mallrave apo shërbimeve, në faturën e fiskalizuar duhet të evidentohen qartësisht të dy momentet.

[Burimi: "Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me procedurat standarde të faturimit në kuadër të procesit të Fiskalizimit"]

Për marrëveshjen e pagesës me këste për detyrime të papaguara

Administrata Tatimore njofton se të gjithë tatimpaguesit që përkohësisht gjenden në situatë të vështirë financiare, mund të paguajnë me këste një detyrim tatimor të papaguar nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore ku ata janë të regjistruar.

[Burimi: "Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me vetpërbushjen e detyrimit të papaguar, marrëveshja e pagesës me këste"]

Dorëzimi i dokumentacionit tatimor

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton të gjithë tatimpaguesit që nuk do të jenë më subjekt i TVSH-së, se duhet të depozitojnë dokumentacionin tatimor (faturat e TVSh-së) pranë Drejtorive Rajonale Tatimore që kanë qenë të angazhuara për shpërndarjen e tyre.

Afati për dorëzimin e fletëve dhe / ose blloqeve të papërdorura nga tatimpaguesit do të jetë periudha 01 Mars – 31 Gusht 2021.

[Burimi: "Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me dorëzimin e dokumentacionit tatimor të shpërndarë nga tatimpaguesit që përjashtohen nga TVSH"]

Taksat kombëtare

Në rastin e shitjes së mineralit të grupit të parë (I), "Mineralet metalike", përqindja e rentës aplikohet në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim.

[Burimi: "Ligj nr. 151/2020 për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar"]

Tarifat doganore

Ndryshohet tarifa doganore për kodin tarifar të NKM 8903 10, "mjetet e tjera ujore për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz", nga 15 për qind në 2 për qind.

[Burimi: "Ligj nr. 168/2020 për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar"]

Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues

Nëpërmjet një Akti Normativ, Këshilli i Ministrave në Republikën e Shqipërisë vendosi shtyrjen e afatit për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues për të gjithë subjektet raportuese deri më 30.06.2021 (aktualisht 31.03.2021). Në vijim të ndryshimeve të miratura, subjektet raportuese do të kenë mundësi të regjistrojnë cdo ndryshim të të dhënave të pronarëve përfitues brenda 90 ditëve (aktualisht 30 ditë) nga data e ndodhjes së ndryshimit.

[Burimi: Akti normativ i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues"]

The procedure for issuing and fiscalizing Order and Summary invoices in the Hotel/ Tourism sector.

For taxpayers, who carry out supply in restaurant services, or other facilities where drinks and food are consumed, and when payment is not made at the time of ordering, the procedure for issuing and fiscalizing invoices is as follows:

The issuance and fiscalization of the order invoice must be done at the same time with the order supply of the customer. An order supply will be considered each table order. This invoice may not be printed but must be issued and fiscalized. If customers from the same table place other orders, then with the delivery of each order is issued and fiscalized the subsequent order invoice, which may also not be printed. Each separate invoice issued for each order must have as payment method marked "order" and the title on the invoice must be "Tax invoice / order".

At the moment of the client's departure, the moment when the payment is made, the taxpayer must issue a summary invoice to the client and fiscalize it. The summary invoice must contain as a reference and included in it, all the separate invoices issued and fiscalized (ie the NSLFs of each separate invoice). Only the fiscalized Summary Invoice will be recorded in the taxpayer's sales book and will be considered for the purpose of calculating VAT on sales. Only at this point, order supply invoices related to the summary invoice are no longer considered for turnover calculations. However, any separate invoice / order and summary invoice must be fiscalized at the time of issue.

[Source: "Notification of the General Directorate of Taxes regarding billing and fiscalization procedure in the tourism sector"]

Billing procedure and payment moment in the hotel services sector

In cases when full or partial prepayment is made during the moment of hotel reservation or during the moment of arrival of the client at the hotel, the fiscalized invoice with the respective VAT is issued in the moment the prepayment is made. This invoice is then submitted in the sale and purchases of the month in which the prepayment is made. In this case, at the moment when the client leaves the hotel, a summary invoice is issued for the service performed. The value of the fiscalized invoice issued at the moment the prepayment made, is reversed and VAT is calculated and submitted for any additional value after the reversal, if any.

In case the client receives additional services during the stay in the hotel, and settles the invoice at the time the service is performed, then this invoice is issued and fiscalized at the time the payment is made and is not included in the summary invoice that can be issued when the client leaves the hotel.

"Order invoices" can be used in all cases when the client stays for a few days in the hotel and pays at the time of departure. Each order invoice for various services, issued to the client during his stay at the hotel, must be included in the summary invoice which is issued at the time of payment. Order invoices do not affect the status of the cash register, as long as no money is collected with this document. The moment of cash receipt is determined by the summary invoice.

[Source: "Notification of the General Directorate of Taxes regarding billing and fiscalization procedure in the tourism sector"]

Faturat "Porosi" dhe "Përmbledhëse" në sektorin e Hoteleri/Turizëm

Për tatimpaguesit, të cilët kryejnë furnizime të shërbimeve të natyrës restorant, apo ambiente të tjera ku konsumohen pije dhe ushqime, dhe kur pagesa nuk kryhet në momentin e porosisë, procedura që ndiqet për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave është:

Lëshimi dhe fiskalizimi i faturës së porosisë duhet të bëhet në të njëjtin moment me furnizimin e porosisë për klientin. Me porosi të kryer nuk kuptohet porosia nga çdo person, por porosia e kryer për çdo tavolinë. Kjo faturë mund edhe të mos printohet por detyrimisht duhet të lëshohet dhe fiskalizohet. Nëse klientët nga e njëjta tavolinë kryejnë porosi të tjera, atëherë me dorëzimin e çdo porosie lëshohet dhe fiskalizohet edhe fatura pasuese e porosisë, e cila gjithashtu mund të mos printohet. Çdo faturë e veçantë e lëshuar për çdo porosi duhet të ketë si metodë pagese të shënuar "porosi" dhe titulli në faturë duhet të jetë "Faturë tatimore/porosi".

Në momentin e largimit të klientit, moment në të cilin kryhet edhe pagesa, tatimpaguesi duhet t'i lëshojë klientit një faturë përmbledhëse dhe ta fiskalizojë atë. Fatura përmbledhëse duhet të përmbajë si referencë dhe të përfshira në të, të gjitha faturat e veçanta të lëshuara dhe të fiskalizuara (pra NSLF-të e secilës faturë të veçantë). Vetëm Fatura përmbledhëse e fiskalizuar, do të regjistrohet në librin e shitjeve të tatimpaguesit dhe do të merret në konsideratë për qëllim të llogaritjes së TVSH-së në shitje. Vetëm në këtë moment, faturat porosi të lidhura me faturën përmbledhëse nuk merren më në konsideratë për llogaritje të qarkullimit. Por, çdo faturë/porosi e veçantë dhe fatura përmbledhëse duhet detyrimisht të fiskalizohen në momentin e lëshimit.

[Burimi: "Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me faturat "Porosi" dhe "Përmbledhëse" në sektorin e Hoteleri/Turizëm"]

Procedura e faturimit dhe momenti i pagesës në sektorin e hotelerisë

Në rastet kur, është bërë arkëtimi i plotë ose i pjesshëm gjatë momentit të rezervimit të hotelit ose gjatë momentit të mbërritjes së klientit në hotel, fatura e fiskalizuar me TVSH-në përkatëse lëshohet në momentin e arkëtimit të parapagimit. Kjo faturë më pas deklarohet në librat e shitjes dhe blerjes në muajin në të cilin është arkëtuar parapagimi. Në këtë rast, në momentin kur klienti largohet, hoteli lëshon fatura përmbledhëse për shërbimin e kryer. Fatura e lëshuar në momentin e parapagimit do të stornohet dhe do të llogaritet dhe deklarohet TVSH-ja për vlerën shtesë stornimit nëse ka.

Nëse për shërbimet e veçanta që klienti merr gjatë qëndrimit në hotel, likujdon faturën në momentin e kryerjes së shërbimit, kjo faturë lëshohet dhe fiskalizohet në momentin e pagesës dhe nuk përfshihet në faturën përmbledhëse që mund të lëshohet kur klienti largohet nga hoteli.

"Faturat tatimore për porosi" mund të përdoren në të gjitha rastet kur klienti qëndron për disa ditë në hotel dhe paguan në momentin e largimit. Çdo faturë porosie për shërbime të ndryshme, të lëshuara klientit gjatë qëndrimit të tij në hotel, duhet të përfshihet në faturën përmbledhëse e cila lëshohet në momentin e pagesës. Faturat e porosisë nuk ndikojnë në statusin e arkës, për sa kohë që nuk mblidhen para me këtë dokument. Momenti i arkëtimit përcaktohet nga fatura përmbledhëse.

[Burimi: "Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me faturat "Porosi" dhe "Përmbledhëse" në sektorin e Hoteleri/Turizëm"]



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

